



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701409/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Rekomandime për përmirësimin e punës të Njesisë së Mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia Bulqizë.*

Drejtuar: **Z. Melaim Damzi**
Kryetar Bashkie

Znj. Merita Xhafaj
Drejtore e Përgjithshme
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Bulqizë

Tiranë

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, duke u nisur nga publikimi në mediat sociale të trasmetimit në emisionin "Le Iene" në mediat italiane lidhur me problematikat e punës së fëmijëve në Bulqizë, të cilët mbledhin mineralin e kromit rreth miniarve, realizoi inspektimin pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Bulqizë në datën 23.11.2017.

Në këtë emisioni të realizuar nga gazetaria investiguese pasqyroheshin kushtet e vështira në të cilat jentonin familjet e fëmijëve të cilët për të garantuar jetësen e tyre ishin të detyruar të punonin duke ju privuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar dhe shfrytëzimin e tyre për punë.

Avokati i Popullit pasi shqyrtojë informacionin nga monitorimi i realizuar ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare.

Objektivat e inspektimit:

- Vlersimi i dokumentacioneve për masat e ndërmarra lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në Njësië për Mbrojtjen e Fëmijëve.
- Vlerësimi i kushteve dhe mjedisit familjar ku jentonin fëmijët.
- Respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një juriste dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtij institucioni, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- Kontrollin i dokumentacioneve përkatëse të cilat lidhen me problematikat e shfaqura në media.
- Inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetonin fëmijët.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit ku u lanë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të raportit.

Profili social i Bashkisë Bulqizë

Bashkia Bulqizë ka në përbërje tetë Njësi Administrative, të cilat janë: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Bulqizës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra.

Nga vlerësimi i dokumentacioneve nga vitit 2015 deri në vitin 2017 kemi një ulje prej 200 familjesh nga skema e ndihmës ekonomike në Bashkinë Bulqizë. Në vitin 2015 në skemën e Ndihmës Ekonomike kanë qënë të përfshirë 580 familje dhe në vitin 2017 janë vetëm 280 familje.

- Për vitin 2015 janë planifikuar 203.548.246 lekë për programin e mbrojtjes sociale (pagesa e Ndihmës Ekonomike dhe pagesat ne kesh) dhe janë realizuar vetëm 178.924.814 lekë pra afërsisht rreth 85% të fondeve.
- Për vitin 2016, janë planifikuar 274.224.00 lekë dhe janë realizuar vetëm 274.215.353 lekë pra 99% të fondeve të mbrojtjes sociale.
- Për vitin 2017, janë planifikuar 278541451 lekë fonde për programin e mbrojtjes sociale dhe janë realizuar 246.961.904 lekë pra 85% të fondeve të mbrojtjes sociale. (duke përfshire edhe marxhin e gabimit ku nuk është përfshirë muaji dhjetor).

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar të dhënat e lartë përmendura realizoi një analizë të thjeshte matematikore mbështetur në treguesit kryesor të programve të mbrojtjes sociale planifikimi/realizimi i fondeve të programit të mbrojtjes sociale (pagesat ne kesh të NE dhe AK) dhe numri i familjeve në skemën e NE për Njësinë Administrative Bulqizë sepse një ndër shkaqet e punës së fëmijës është situata e vështirë social-ekonomike e familjeve.

Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia Bulqizë ka një popullsi prej 32,210 banorësh ndërsa Njësia Administrative Bulqizë ka një popullsi prej 12 600 banorë. Në këtë njësi janë 281 familje në skemën e Ndihmës Ekonomike, me një mesatare prej 4.5 banorë për familje. Pagesa mesatare e Ndihmës Ekonomike që duhet të përfitojnë këto familje është rreth 3.000 – 3.800 lekë në muaj.

Pavarsisht se kemi patur një ulje të numrit të familjeve nga skema e Ndihmës Ekonomike me rreth 40%, kemi një rritje të planifikimit të fondeve të programit të mbrojtjes sociale me rreth 70% nga viti 2015 në vitin 2017, dhe masa mesatare e pagesës së NE nuk ka

ndryshuar. Realizimi i fondeve të programit të mbrojtjes sociale ka qënë më i ulët pikërisht në vitin 2015, kur numri i familjeve në Skemën e Ndhmës Ekonomike ka qënë më i lartë.

Nga analiza e lartë përmendur konkludojmë se fondet e mbrojtjes sociale nga buxheti i shtetit janë të konsiderueshme, skema e ndihmës ekonomike nuk është tregues kryesor i cili ndikon në përmirësimin e situatës social-ekonomike të familjeve të varfëra, i cili është një ndër shkaqet kryesore të lindjes së problemeve sociale sic është edhe puna e fëmijëve në rastin në fjalë. Trajtimi i problemeve sociale, në rastin në fjalë duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale si në strehim, shërbime publike sic janë arsimi, shëndetësia dhe shërbime sociale të integruara.

Në këtë kontekst duke vlerësuar edhe objektivat madhor të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2016-2020 dhe planin e vëprimit të zbatim të tij, e cila parashikon në cdo detaje qasjen gjithëpërfshirëse kërkojmë të realizohet një vlerësim i planit të veprimit të kësaj strategjie për vitin 2016-2017, për të mundësuar integrimin e familjeve të skemës së ndihmës ekonomike nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale me fondet e programit të mbrojtjes sociale.

Paketa e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Bulqizë

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit realizuan takimin me Drejtorin e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Bulqizë. Nga intervista e realizuar u informuam se organograma e Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Bulqizë përbëhet nga 1 drejtor dhe katërmëdhjetë punonjës. Kjo drejtori trajton, Pagesat e Ndhmës Ekonomike (ku përfshihen edhe të gjithë punonjësit e ndihmës ekonomike në njësitë administrative të Bashkisë Bulqizë, Pagesat e Aftësisë së Kufizuar, Barazine Gjinore dhe dhunën në Familje, Mbrojtjen e Fëmijëve, shërbimet ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Nga vlerësimi i dokumentacioneve, në zyrën e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Bulqizë ndodhej drejtori, një specialist për Ndhmën Ekonomike, një specialist për aftësinë e kufizuar (pagesat në kesh), një specialist i barazisë gjinore dhe dhunës në familje si dhe një specialist për njësi të mbrojtjes së fëmijëve dhe marrëdhëniet me OJF-te, vend i cili ishte vakantë si rezultat i largimit të specialistes në një pozicion tjetër. Bashkia kishte filluar procedurat për punësimin e një punonjëse të re. Gjithashtu nën varësinë e kësaj drejtorie janë edhe administratorët shoqëror, shtatë specialitet të ndihmës ekonomike të njësitë administrative Martanesh, Trebisht, Fushe Bulqizë, Zerqan, Ostren, Shupenzë dhe qendrën rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar ndodhet një specialist dhe një sanitare.

Lidhur me krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në këtë bashki si detyrim ligjor që rrjeth nga neni 24 të ligjit Nr. **139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ku thuhet se “Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”** u informuam se në këtë bashki është ngritur një qendër rehabilituese ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar, ku marrin shërbime 6 fëmijë nga moshën 3-14 vjeç nga fondet e bashkisë. Kur qendra ka filluar funksionimin e saj përfitonin shërbime të përkujdesit social 13 fëmijë. Për nënat kryefamiljare bashkia ka caktuar një fond për mbështetjen me pagesa në kesh të tyre, ku cdo kryefamiljare përfiton një masë prej 1100 lekë cdo muaj. Ndërsa për familjet në varfëri ekstreme si edhe në rastet e

emergjencave bashkia ka shpërndarë paketa ushqimore. Bashkia ka 18 banesa sociale, ku 6 prej tyre nuk funksionojnë sepse kanë nevojë për rikonstrukcion, pasi janë jashtë standarteve normale.

Institucioni i Avokatit të Popullit vleron fillimin e punës të kësaj bashkie për krijimin dhe administrimin shërbimit sociale si qëndrën rehabilituese ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbështetjen e financiare të nënave, kryefamiljare, mbështetjen me paketa ushqimore të familjeve ekstremisht të varfëra. Në këtë kontekst, si dhe në zbatim të detyrimeve ligjore nisur edhe nga të dhënat e sipërcituara, domosdoshmërisht lind nevoja për punësimin e një eksperti për fëmijët me aftësi të kufizuara (pedagogji e specializuar) për të përmbushur standardet e përkujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara në qendra rezidenciale dhe ditore në zbatim të *Vendim nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”*. Banesat sociale duhet të rikonstrukturohen për të plotësuar nevojat e qytetarëve të këtij bashkie. Për të plotësuar të gjitha nevojat e komunitetit dhe kategorive në nevojë bashkia duhet të fillojë punën për krijimin e tipologjive të reja të shërbimeve sociale për kategoritë në nevojë si të moshuarit, shërbimin e emergjencës, shërbimin e kujdestarisë ligjore për fëmijët etj.

Detyrimet ligjore që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nenit 35, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Bashkia e Bulqizës pjesërisht ka realizuar ngritjen e strukturave përgjegjëse të administrimit shërbimeve të kujdesit social të cilat kanë për funksion/detyrë (i) identifikimi i nevojave për territorin që mbulon (ii) vlerësimi i nevojave në bazë të hartës së vulnerabilitetit, (iii) hartimi i Planit Social; (iv) programimi buxhetor; (v) planifikimi dhe sigurimi e ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqërore; si dhe (vi) ngritja e Shportës bazë të shërbimeve shoqërore.

Sfidat me të cilat duhet të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re administrative konkretisht Bashkia Bulqizë është vlerësimin i nevojave të komunitetit për shërbime sociale të cilat do të hapin rrugë hartimit të planit social të kësaj bashkie bashkëlidhur me programimin buxhetor përkatës. Këto hapa sjellin dhe krijimin e paketës bazë të shërbimeve sociale për këtë Bashki si hapja e një qendre sociale për të moshuarit etj në dobi të banorëve.

Mbrojtje e fëmijëve nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, strukturë pranë Bashkisë Bulqizë

Në zbatim të VKM nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” Institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi dosjet e fëmijëve të cilët janë shfaqur në emisionin e publikuar në emisionin “Le Iene” në mediat italiane të cilët banojnë në Njësinë Administrative Bulqizë. Nga mungesa e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës procedurat e ndjekura për këta dy fëmijë nuk ishin realizuar plotësisht. Konkretisht kishte përfunduar vetëm vlerësimi i familjes së fëmijës me inicialet E.P ndërsa për fëmijën tjetër me inicialet A.H vlerësimi i familjes dhe riskut të fëmijës nuk është realizuar pasi kanë refuzuar familjarët sipas informacionit të dhëna nga drejtori i shërbimeve sociale me profesion punonjës social i cili është personi që ka realizuar vlerësimin e familjes. Ky vlerësim i është vënë në

dispozicion edhe Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, institucion nën varësinë administrative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjithë ky proces është realizuar nga fillimi deri në fund vetëm nga një figurë profesioniste, të cilën nuk e ka as detyrë funksionale të tij, jo vetëm në kuadrin e pozicionit të punës por edhe nga detyrimet që rrjedhin nga **Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”**.

Nga kontrolli i formularit të vlerësimit institucioni i Avokatit të Popullit vëzhgoi: Në rubrikën **“Sfondi familjar”** thuhet se *“shtëpia e tyre ndodhet në lagjen “Gjeologu” fare pranë minierës së kromit dhe ndërtesa e tyre nuk plotëson kushtet bazë të jetesës dhe kushtet higjieno sanitare edhe pse babi i fëmijës punon në një nga minierat e kromit në zonën e Bulqizës ndërsa nëna e fëmijësështë përfituese e grupit të plotë (dm.th përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar grupi i parë).....ndërsa në rubrikën **“Kapaciteti i Prindërimit&Aftësia për ta përballuar”** thuhet se *“Dua të theksoj se pavarësisht që i ati është i punësuar, ai abuzon me alkolin, po gjë të tillë nuk e shfaq në dhunë (qoftë fizike dhe verbale) tek antarët e tjerë të familjes. E ema duke qene se është e paaftë e ka të vështirë të kujdeset për antarët e tjerë, në një kujdesje normale pasi ka problem me frymarrjen dhe lëvizjet i ka të kufizuara”*. Mosha e fëmijës është 10 vjeç, ndjek procesin mësimor në shkollën “Xhevdet Doda”, Bulqizë. Në rubrikën, **“Risqet dhe rreziqet për fëmijën”** thuhet se *“Nuk ka”*. Treguesit e rubrikave të lartë përmendura ku si përfundim del se (i) banesa është totalisht e papërshtatshme për jetëse, (ii) babai abuzon me alkoolin,(iii) nëna me aftësi të kufizuara dhe ka vështirësi për mirërritjen e fëmijëve nuk mund të dalin në konkluzionin se “nuk ka” risk për fëmijën. Cdo akt ligjor dhe nënligjor është harutur dhe miratuar në parimin e intresit më të lartë të fëmijës e parashikuar në Konvetën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve si edhe në pikën 3, të nenit 6, të ligjit Nr. 8/2017 datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ku thuhet se *“Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysht:**

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysht situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

Moszbatimi i akteve ligjore në fuqi, ku vlersimi i riskut të fëmijëve duhet të realizohet nga ekipi multidisiplinar i figurave profesionale të cilat operojnë në nivel vendor, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, administrator shoqëror, mësuesi, mjeku, policia ku prezente duhet të jene edhe familjarët dhe vetë fëmija të cilët kanë lidhje me fëmijën.ose familjarët e fëmijës ka sjell një proces fektiv në trajtimin e fëmijës duke parë interesin më të lartë të tij.

Në këtë kontekst, Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin se vlerësimi i riskut të fëmijës jo vetëm nga ana procedurale që nuk është respektuar parimi i interesit më të lartë fëmijës por edhe në kontekstin material, si rezultat ka sjell dhe mos

përfundimin e procesit për hartimin e planit të mbrojtjes së fëmijës, proces i cili është monitoruar edhe nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Gjetjet e raportit:

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që të sigurohet një bashkërendim efektiv midis Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për raste specifike, kur konstatohet mungesa e punonjësit të Njësisë Për Mbrojtjen e Fëmijëve në rastin konkretë, të cilat ndikojnë negativisht në trajtimin e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre. Nga vëzhgimet përfundimtare të realizuara nga monitorimi i shërbimeve shoqërore të këtë Bashki konstatohet se nuk kemi mungesë të fondeve të mbrojtjes sociale të cilat nuk janë realizuar por mungesë të akteve ligjore të cilat do të sillnin një investim të këtyre fondeve të porealizuara në krijimin e shërbimeve sociale në këtë Bashki.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar "*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*";

REKOMANDOJMË:

1. *Marrjen e masave për vlersimin e riskut të fëmijëve me inicialet S.P dhe A.H dhe hartimin e planit të mbrojtjes së fëmijëve në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" nga ekipi multidisiplinar.*
2. *Marrjen e masave për mbështetjen e procesit të vlersimit të riskut dhe hartimit të planit të mbrojtjes nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve si rezultat i mungesës së punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në këtë Bashki.*
3. *Marrja e masave nga Bashkia Bulqizë për të sistemuar familjen e fëmijës me inicialet S.P në banese sociale.*
4. *Marrjen e masave për fillimin e punës përgatitore të vlersimit të nevojave për shërbime sociale për bashkinë Bulqizë duke garantuar hartimin e planeve sociale dhe programeve buxhetore përkatëse në bashkëpunimin me organizata jo-qeveritare si Save the Children, "Terre des hommes" etj*
5. *Marrjen e masave për raport-vlersimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2016-2020 dhe planin e veperimit të zbatim të tij për vitin 2016-2017.*
6. *Marrjen e masave për vlerësimin dhe hartimin e akteve ligjore për të mundësuar shpenzimin e fondeve të porealizuara (te cilat nuk realizohen edhe i rikthehen buxhetit të shtetit) në ngritjen e shërbimeve sociale për cdo bashki nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
7. *Marrjen e masave për të punësuar një specialiste (pedagogji e specializuar) në qëndrën rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar.*
8. *Marrjen e masave për përfundimin e procedurave për punësimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Bulqizë në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin Nr. 8/2017 datë 23.2.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar ku përcaktohet se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve.

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI